

BREZI


Revistë periodike

Plus

Janar - Mars 2024 Nr.2

Jorgo Papingji

Kinomatografia "Shqipëria e Re"



**Poezi
Barcaleta
Shëndet**



**Botim periodik
Letrare
Shoqërore e
Kulturore**

**Boton:
Albanika ET- Tetovë**

**Redaktor përgjegjës:
Alba Jahiu**

**Redaksia:
Valon Elmazi
Mimoza Jahija
Amir Izairi
Ylber Jahiu**

**Adresa e redaksisë:
Rr. Bllagoja Toska Bllok 82, CA-
nr6 – Tetovë
Contact. 072 639 105**

e-mail: albanika19@hotmail.com

**Publikimi:
<https://top24.mk/category/libra-revista/>**

ISSN 2671-387X

Janar-Mars , 2024

**Revista u ndihmua nga Ministria e
Kulturës e Rpublikës së Maqedonisë
së Veriut**



Fjala e redakësisë

Revista letrare “Brezi Plus” është përpjekje për t’u rikthyer mes rinisë, intelektualëve dhe bashkëvendësve tanë, për të rikthyer një pjesë të vlerave dhe pasurive kulturore shqiptare të cilat ngadalë po shuhen dhe harohen ndaje disa edhe janë në zhdukje duke mos parë dritën. Nga ky këndvështrim në këtë numër redaksia e “Brezi Plus” ju sjell materiale për figura të shquara kombëtare si ajo e **Jorgo Papingji**, Folklori shqiptarë, shkencëtarin Albet Ainshtajn, kinematografinë e parë shqiptare Shqipëria e Re. Sjellja e materialeve të tilla në mesin tonë në këtë revistë janë tendencë për të dokumentuar veprën e tyre me të vetmin qëllim që lexuesi sot të ketë informacion profesional.

Revista “Brezi Plus” gjatë botimit të numrave, në vazhdimësi rëndësi të veçantë do t’ju kushtoj figurave të shquara kombëtare duke sjellur dokumente dhe materiale të rëndësishme.

Duke u munduar të kontribuojmë në pasurimin e tregut letrarë besojmë që kjo revistë do të plotësoj hapsirën e munguar në vite në vendin tonë.

Me respekt! Redaksia e “Brezi Plus”

JETA DHE VEPRA JORGO PAPINGJI

Jorgo Papingji një emër i mrekullueshëm që është dëgjuar shumë në Festivalet e RTSH-së, një nga emrat më përfaqësues të muzikës shqiptare, qoftë popullore, të përpunuar apo asaj të lehtë, ku me anë të teksteve të shumta, të shtrira në kohë prej dyzet e ca vitesh, në audicionet e tjera muzikore për të rritur e fëmijë, krijoi një profil krejt të veçantë poetik e artistik.



Në të gjitha anët e Shqipërisë dhe të botës shqiptare, fjalët e teksteve të tij kanë një komunikim të gjerë me shikuesit e shumë, kudo ku flitet shqip, ku emri i tij është një emër i mirënjohur e i nderuar, që iu thotë aq shumë adhuruesve të këngës, në të gjitha moshat dhe nivelet e shoqërisë shqiptare.

Emri i tij është bërë vulë e muzikës së lehtë shqiptare. Thesari i këngëve të shquara ka vargjet e veta.

Papingji ka lindur në Vlorë më 10 qershor 1942. Ka shkruar pesë këngë fituese në "Festivalin e Këngës", një prej të cilave ka marrë pjesë në Festivalin European të Këngës në vitin 2014. Është autor i nderuar me titullin "*Mjeshtër i Madh*".

Tekstet e tij të kompozuar nga kompozitorë të shquar dhe kënduara nga këngëtarë e këngëtare sharmante janë bërë hite, sidomos disa këngë të mirënjohura festivalesh dhe ciklet e këngëve për fëmijë, ku stilizohen në mënyrë poetike lojërat e shumënjohura fëmijërore.

Me poezi dhe shkrime Jorgo Papingji nisi të merret, nga mbarimi i klasës së katërt fillore, ishte aktiv në dy gazetatat e shkollës, njëra

humoristike dhe tjetra serioze, me krijimtarinë e tij, sidomos në lëmin e poezisë, ku emri i tij ishte ndër emrat kryesorë. Si të gjithë poetët, poezia e tij merr rrugë me fletoret intime të vjershave, me vargjet e para për dashurinë, për vete apo për ndonjë shok a shoqe që ia kërkonte, shkëmbimi i mesazheve me anë të vargjeve, një modë tanimë e harruar, për shkak të nofullës kërcënuese të celularit dhe internetit ndaj adoleshentëve dhe brezit të ri.

Jorgo Papingji ka mbaruar studimet e larta për shkencë ekzakte (matematikë-fizikë) dhe ka qenë një mësues i pasionuar dhe drejtor në disa shkolla në Tiranë e gjetkë, por kënga e rrëmbëu në krahët e saj të lehtë dhe e shpuri drejt një ëndrre të guximshme. Ritmet e muzikës e morën me vete, duke bërë që ajo që ai e konsideronte si "punë të dytë", marrja me tekste këngësh, të bëhej e para dhe të përcaktonte vetë individualitetin e tij si njeri, si poet dhe si artist, me një audicion të gjerë pikëtakimesh emocionale në kohë-hapësirën estetike të botës shqiptare.

Në gazetën "Zëri i rinisë" për herë të parë botoi poezi dhe që nga ajo kohë Jorgo Papingji dhe poezia kanë qenë miqë të ngushtë e të pandarë, veçse destinacioni i këtyre poezive nuk kanë qenë më kolanat e gazetave dhe librat, siç ka ndodhur me pjesën dërmuese të poetëve, por studiot e radiove dhe ato televizive, ku poezitë e tij janë kthyer në tekste të mrekullueshme këngësh dhe janë shpërndarë si zogj ogurbardhë në të katër anët e vendit.

Kënga *A ta fshij apo ta gris* ishte bashkëpunimi i parë si autor teksti me kompozitorin e shquar Aleksandër Lala. Ishte një këngë për fëmijë, që aso kohe ngjalli shumë reagime pozitive dhe emocione estetike.

Në Festalet e Fëmijëve, pati një përkushtim dhe ndjenjë pasionante, që e bëri poetin të gjurmonte lojërat e fëmijëve dhe mbi to të ndërtonte tekste, që do të këndoheshin nga të vegjlit dhe do të bëheshin këngë hite, të cilat do të qarkullonin në të gjithë Shqipërinë, në kopshte, shkolla, mjedise social-kulturore, mjedise çlodhëse, plazhe, pishina, tek lodrat dhe kudo ku kryenin veprimtarinë e tyre fëmijët. Po ta kujtojmë këngën *Hapa dollapa* që Jorgo Papingji e ka ndërtuar mbi fabulën e lojës kukafshehtas, ku funksionojnë në një teksti dhe muzika, temporitmi i lojës dhe temporitmi i këngës, kënduar me pasion dhe shpirtdëlirësi nga të vegjlit. Në debutimin e tij në Festalet e Këngës për Fëmijë Papingji ka marrë pjesë me qindra tekste dhe është vlerësuar nga juritë artistike të kohës me njëzet e gjashtë çmime.


Tekstet e tij për këngëtarët ikona të muzikës popullore shqiptare si Hafsa Zyberi, Bik Ndoja, Luçie Miloti etj janë pika reference për shpirtin e muzës së gjallë e të pashtershme të folkut, i cili është vetë shpirti i identitetit gjenetik e psikoentik të një kombi. Tekstet e këngëve për dibranët që u vendosën në Tiranë, për skrapalinjtë, për pleqtë e Kavajës etj, janë vetëm disa nga ato dhjetëra e qindra tekste, që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë një audiencë të gjerë ndër dashamirët dhe adhuruesit e këngës popullore.

Ndër këngët e shkruara nga Papingji veçohen: *Kur të jemi bashkë dy* e vitit 1980, kënduar nga Luan Zhegu, *Askush nuk do ta besojë* dhe *Fati dhe jeta*, kënduar nga Anita Bitri, *Kur humba një dashuri*. kënga fituese kënduar nga Manjola Nallbani, *Rri me mua*, kënduar nga Mira Konçi, *Thuaj no*, kënduar nga Ardit Gjebrea, *E doni armen*, kënduar nga Luan Zhegu dhe Ledina Çelo, *Nuk jam tribu* fituese. këngë e kënduar nga Aurela Gaçe dhe shumë këngë të tjera.

Lirizmi i Papingjit, mprehtësia dhe finesa e detajeve, temporitmi i thellë dhe intonacionet befasuese, qoftë ritmike qoftë të strukturave kompozicionale, thjeshtësia gati tronditëse, me të cilën ai na përcjell të vërteta të mëdha, sa njerëzore e kombëtare, aq dhe universale, e bëjnë atë një poet të papërsëritshëm, një zë të fuqishëm të poezisë së re shqipe, jo për nga moshën, por për nga filtrat modernë dhe tradicionalë njëherësh, me të cilat ai operoi në rrugëtimin e tij të gjatë dhe të pakthyesëm poetik.

Jorgo Papingji është shuar në moshën 81-vjeçare më 21 Mars 2024.

"Lamtumirë mjeshtër Jorgo Papingji! Largimi juaj nga kjo jetë erdhi në Ditën Ndërkombëtare të Poezisë! Kontributi juaj i jashtëzakonshëm në vargje, i përkthyer mjeshtërisht në këngë, është një trashëgimi e vlefshme që do të mbetet përgjithmonë pjesë e artit shqiptar. Kujtimi juaj do të jetë gjithmonë burim i frymëzimit për të gjithë brezat e ardhshëm", ka shkruar ministrja Gonxhja.



Shirine Morina – Ikona e komedisë shqiptare

KOMEDOA SHQIPTARE NË ROLET E AKTORES

SHIRINE MORINA

Aktori luan derisa të vdesë- do të thoshte aktorja Shirine Morina me karrierë mbi katërdekadëshe si aktore.

Janë dhjetëra role që aktorja Shirine Morina do t'i jetësonte në skenën teatrore e sheshxhirimet e filmave. Është një nga ikonat e komedisë në vend. I takon brezit të artë që kishin kultivuar vlerat e artit skenik të cilat do të përcilleshin në gjeneratën e re të artistëve. Aktorja Shirine Morina vdiq në moshën 72 vjeçare.

E lindur më 27 maj të vitit 1951 në Prishtinë, do të merrte hapat drejt aktrimit me përgatitjen profesionale në grupin e aktrimit në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prishtinë. Do t'i bashkohej atij që ishte Teatri Popullor i Kosovës më 1969, ku do të interpretonte rolet që do ta gdhendnin figurën e saj prej aktoreje.

Midis të tjerash, ka luajtur si Magjistarja në shfaqjen “Makbethi”, si Zonja në “Ana Karenina”, si Krali në shfaqjen “Me sytë e Kllaunit”, si Gruaja në shfaqjen “Golgota”, si E bija në “Shtettrrethimi”, si Zhaneti në “Hotel Kashta” si Meribanja në “Mosha e bardhë” e si plaka Nicë në shfaqjen “Gjenerali i ushtrisë së vdekur”.

Ajo i takon plejadës së aktorëve që kanë ndriçuar historinë e artit në vend. Me talentin që kishte e përvojën e saj në skenë do të shfaqej edhe në role të tjera si Lypësja në “Dasma e përgjakur”, si Mysafirja në “Retrovizori”, si Antoneta në “Miza në vesh”, si Nëpunësja në “Mjalti i hidhur”, si Hajrija në “Prefekti”, si Shtriga në “Magjistarja”, si Ruzhdja në shfaqjen “Spiuni”, si Adela në “Milionarët”, si Lulja në “Orkideja” e shumë të tjera. Kolegët e kanë vlerësuar si vlerë të shtuar në botën e teatrit.

Aktori Selman Jusufi ka thënë se aktorja Morina i takon gjeneratës së çmuar artistike në vend e në rajon.



“Kolegia ime Shirine Morina sot ia dorëzoi trupin dhe shpirtin një publiku që sot më nuk duartroket, nuk ekziston. I përket një gjenerate të artë, ka shkuar në heshtje. Kam pasur fatin t'i takoj një gjenerate të artë kur teatri i Prishtinës dhe ai i Shkupit kanë qenë diamante të kulturës shpirtërore artistike të kombit shqiptar jo vetëm në Kosovë por edhe në krahina të tjera”, ka thënë ai duke u shprehur se kohëve të fundit aktorja Morina ishte harruar nga publiku, ekrani e komuniteti artistik.

“Drama është gjuhë mistike, ka elemente sakrale, rekuizita që e mbajnë publikun të lidhur. Vjen një ditë, një çast, sikur sot me Shirinen, aktorja i la personazhet, tekstin, autorin, regjisorin, kostumografin. Krejt çfarë ka pasur, i la. Ajo ishte në pension, por tërë jetën e saj ka jetuar me teatrin, nuk ka pasur gjë tjetër. Ajo ka qenë një murgeshë e një katedraleje që quhet Teatër Kombëtar. Kjo është gjenerata e artë që po shkon në heshtje. Për fat të keq këta njerëz pakkush i njeh, institucionet tona nuk dinë se kush janë”, ka thënë aktori Selman Jusufi, bashkëpunëtor i aktorese së ndjerë në disa shfaqje.

Sipas tij, ajo ka pasur fat që i ka takuar një periudhe ku vlerat teatrore janë kultivuar si “piemont i vlerave artistike e kombëtare”.

Pos në teatër, aktorja Shirine Morina kishte interpretuar edhe në filma, seriale e radiodrama. Rolet e saj përfshijnë edhe projektet “Era dhe Lisi”, “Kur pranvera vonohet”, “Përroi vërshues”, “Qesh e ngjesh”, “Fidani”, “Në autobus”, në serialin “Banda e Luta Fukarasë”, “Pa pengesa” e “Cimerat”.

Komedia ishte njëra prej zhanreve në të cilat do ta shtrinte aktivitetin e saj. Sipas regjisorit Agim Sopi, aktorja Shirine Morina ka qenë njëra prej shtyllave që e kanë mbajtur komedinë. Atë e ka vlerësuar si njëren prej artisteve që kanë ndërtuar identitetin e teatrit në vend.

“Shirine Morina është njëra prej aktoreve të plejadës së ekipit të artë do ta quaja të periudhës kur teatri i Kosovës ka qenë ndër teatrot më të mira të rajonit dhe më gjerë sigurisht. Ajo, bashkë me koleget e saja, bën pjesë në ekipin e shkëlqyer të asaj gjenerate që ka ndërtuar identitetin e teatrit tonë. Shirini ka qenë e veçantë sidomos për zhanrin e komedisë dhe pothuajse ka qenë shtylla kryesore e botës femërore që e ka mbajtur atë zhanër për vite të tëra në teatrin e Kosovës”, ka thënë regjisor Sopi.

Sipas tij, figura e Morinës ishte mbuluar me pluhurin e harresës.

“Fatkeqësisht, si gjithë aktorët që mbulohen me pluhurin e harresës, edhe ajo ka qenë për një kohë të gjatë e tillë, e harruar, e ekskomunikuar, e lënë diku nëpër marrëzira. Sot kujtohem kur ka vdekur, me siguri se tingëllon paksa hipokrite”, ka thënë regjisor Agim Sopi.

Dramaturgu e regjisor Qemajl Sokoli e ka kujtuar aktoren Shirine Morina si të afërt, të gjallë e atdhetare.

“Lajmi i befshëm për shkuarjen në amshim, të njëres prej aktoreve të shkolluara, të hareshme e të suksesshme të skenës dhe të ekranit tonë - Shirine Morina, më ka prekur thellë... Shirine Morinën, si kolegen apo bashkëpunëtoren e kam njohur kaheerë, dhe ka qenë e afërt, e sinqertë, e shoqërueshme, e gjallë dhe atdhetare e flakët”, ka shkruar Sokoli.


Morina është kujtuar edhe nga teatri i qytet “Adriana” në Ferizaj.

“Sot paska ikur në amshim aktorja e teatrit, filmin e televizionit - Shirine Morina. Kontributi i saj do të kujtohet gjithmonë e veprat e saj do të ruhen e kultivohen kudo. Ngushëllimet më të sinqerta familjarëve, miqve e kolegëve te saj!”, shkruhet në postimin e Teatrit të qytetit të Ferizajt.

“Sot humbëm një nga figurat e shquara të skenës artistike në Kosovë, znj. Shirine Morina. Aktorja e njohur, e cila shënoi një epokë të rëndësishme në historinë e teatrit dhe kulturës kosovare, la pas një trashëgimi të çmuar. E takoja miken time shpesh dhe ishte shumë pozitive dhe plotë energji. Ngushëllime familjes dhe gjithë komuniteti artistik!”, shkroi Bajqinovci në Facebook.

“Aktori luan derisa të vdesë”- do të thoshte aktorja Shirine Morina me karrierë mbi katërdekadëshe si aktore.

“Gjithmonë e doja skenën, më tërhiqnin edhe dërrasat e skenës. Atë kohë nuk ka pasur shumë aktore vajza. Edhe prindërit e mi kanë qenë kundër, donin që unë të vazhdoja juridikun apo ekonomikun, por unë doja aktrimin”, do të thoshte ajo në emisionin “Anima” të Kohavisionit në nëntor të vitit 2014.

ALBERT AJNSHTAJNI, FIZIKANTI I PAPËRSËRITSHËM

Shkenca është gjë e mrekullueshme nëse njeriu nuk duhet të fitojë të hyrat e jetës nga ajo.

Albert Ajnshtajni ishte një qytetar i botës, si e cilëson ai veten me origjinë hebreje që mbahet ndryshe si maja e paradigmës në Fizikë sot për sot në lidhje me Teorinë e Relativitetit. Në botën e dijeve shumica kanë qenë me origjinë hebreje, madje janë edhe sot.

Fëmijëria e Ajnshtajnit

Albert Ajnshtajni lindi në Ulm të Gjermanisë në vitin 1879, në një familje hebrenjsh. I ati ishte pronar i një fabrike që prodhonte pajisje elektrike, ndërsa e ëma pëlqente librat dhe muzikën. Vetë Ajnshtajni ishte fëmijë i mbyllur, i cili filloi të fliste vonë dhe kishte vështirësi të mësonte për të lexuar.

Kur mbushi pesë vjeç, i ati i dha një busull, që menjëherë i ngjalli djalit një interes të paparë për gjilpërën magnetike dhe fenomenet natyrore që shkaktonin lëvizjen e saj në të njëjtin drejtim.

I ati i shpjegoi se kjo shkaktohej nga fusha magnetike dhe forca e rëndesës. Ajnshtajni e kishte të vështirë të kuptonte koncepte të tilla në atë moshë.

Në komentet e tij për vitet e fëmijërisë, Albert Ajnshtajni kujtonte se nuk e kishte me qejf shkollën. Metoda e prerë mësimore, ku nxënësve nuk u lejohej të bënin pyetje e bënte atë të ndjehej si i burgosur.

Dëshira e Ajnshtajnit për matematikën


Por me kalimin e viteve, fizikani i ardhshëm zhvilloi një dashuri të madhe për matematikën. Ai filloi të mësonte logaritmet dhe pjesë të tjera të vështira të matematikës, ndërkohë që moshatarët e tij ende mësonin aritmetikën e thjeshtë.

Albert Ajnshtajni ndoqi më pas Institutin Politeknik në Zyrh të Zvicrës, ku studioj fizikë dhe matematikë. Pas diplomimit Albert Ajnshtajni punoi për qeverinë zvicerane si inspektor patentash për shpikjet e reja. Gjatë kësaj periudhe filloi punën për teoritë e tij të

ardhshme shkencore, të cilat i botoi për herë të parë në vitin 1905.

Në një nga punimet e tij shkencore Albert Ajnshtajni shpjegon se drita lëviz përmes valëve dhe pjesëzave, një nga elementët e rëndësishëm të teorisë së tij kuantike.

Në një tjetër punim ai flet për pjesëza të vogla që pluskojnë në lëngje apo në trupa të gaztë, e cila mbështet teorinë e përbërjes atomike të materies.



Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit

Sipas Ajnshtajnit teoria më e rëndësishme është ajo e relativitetit, si drita lëviz gjithmonë me të njëjtën shpejtësi, pavarësisht nga burimi i saj. Por ai shtoi se koha dhe masa mund të ndryshojnë dhe varen nga vend-ndodhja e një personi në raport me një objekt apo një ngjarje.

Dhjetë vjet pas botimit të teorisë së relativitetit, Ajnshtajni botoi *Teorinë e Përgjithshme të Relativitetit* ku zgjeron teorinë e tij mbi objektet në lëvizje. Ajnshtajni thotë se objektet humbasin masë kur emetojnë dritë, pasi drita është një formë energjie.

Në vitin 1921 Ajnshtajni fitoi Çmimin Nobel në Fizikë për zbulimin e ligjit të efektit fotoelektrik. Ky ligj shkencor shpjegon përse disa metale emetojnë elektrone pasi mbi sipërfaqen e tyre bie drita. Ky zbulim çoi në zhvillimin e elektronikës, përfshirë edhe radios dhe televizionit. Ai ka qenë me plot gojë gjeni. Gjenialiteti i tij ishte i pashembullt. Një

shkencëtar i adhuruar nga bota mbarë, antisemitist, publicist dhe antinazist, professor dhe autoritet shkencor. Ai largohet nga Gjermania naziste kur ajo fillon e bëhet e rrezishkme për hebrenjtë dhe me famën e tij fiton një fond të palimitueshëm për atë kohë për të zhvilluar shkencën.

Megjithë famën e tij, Ajnshtajni ishte një njeri i thjeshtë, i veshur me rroba të vjetra dhe me flokë që dukeshin të pakrehur. Studentët e tij tregojnë se ai kishte aftësinë të ilustronte ide shumë të vështira me figura dhe krahasime që i bënin ato shumë të kuptueshme.

Albert Ajnshtajni është personaliteti më i madh i shkencës në shekullin e XX. Një nga figurat që ndriçoi njerëzimin me pikëpyetjet që e mbulojnë Universin, si dhe një pasues i denjë pas Galileo Galilos në Fizikë, dhe me të vërtetë "Globi rrotullohet" por me një lakueshmëri dhe në kohë, me një energji sa material shpërfaqet në ndryshueshmëri. Ai është ndryshe fizikanti me ndikimin më të madh në botën e fizikës dhe të astromomisë, por gjithashtu edhe i konceptit në lidhje me të vërtetën absolute që e shpall atë me relativitet. E vërteta absolute si e ndikimit Aristotelian dhe më pas dogmatik në mesjetë bie komplet si koncept bashkëkohor.

Mbahet si shpallës i një revolucioni të gjithanshëm shkencor në vitet '60 sipas Tomas Kuhn historianit të shkencës.

Megjithëse ishte kundër luftës, Ajnshtajni i shkroi presidentit amerikan Franklin Ruzvelt në vitin 1939 për ta nxitur që Shtetet e Bashkuara të prodhonin bombën bërthamore para Gjermanisë. Albert Ajnshtajni vdiq në moshën 76 vjeçare në vitin 1955.

Disa gjëra që nuk i keni ditur për Ajnshtajnin:

Ishte duhanpirës i çmendur

Ajnshtajni adhuronte të pinte duhan. Ndërsa bënte ecejake mes shtëpisë dhe zyrës së tij në Princeton, shpeshherë e shihnin të shoqëruar

pas nga tymnaja. Thuajse pjesë e pandarë e imazhit të tij, si flokët e kreshpëruar dhe rrobat e gjera, çibuku ishte pjesë e pandashme e Ajnshtajnit.

Në vitin 1950, Ajnshtajni shprehet: “Unë besoj se pirja e duhanit me çibuk kontribuon në një gjykim disi të qetë dhe objektiv tek të gjitha çështjet njerëzore”. Megjithëse, parapëlqente çibukët, Ajnshtajni nuk ishte nga ata që kthente mbrapsht një puro apo qoftë edhe një cigare të thjeshtë.

Projektoi një frigorifer

Njëzet e një vjet pasi shkrimi Teorinë e tij të Veçantë të Relativitetit, Albert Ajnshtajni shpiku një frigorifer që operonte me gaz alkoolik. Frigoriferi mori patentën në vitin 1926, por nuk hyri kurrë në prodhim, sepse e nxorri jashtë loje teknologjia e re.

Ajnshtajni shpiku frigoriferin, sepse lexoi për një familje që ishte helmuar nga dioksidi i sulfurit që kishte lëshuar frigoriferi.

Urrente çorapet

Një pjesë e sharmit të Ajnshtajnit ishte edhe pamja e tij e çrregullt. Përveç flokëve të kreshpëruar, një nga zakonet e veçanta të Ajnshtajnit ishte se nuk vishte çorape.

Pa e vrarë mendjen nëse ishte duke lundruar apo në një darkë zyrtare në Shtëpinë e Bardhë, Ajnshtajni shkonte kudo pa çorape. Për Ajnshtajnin çorapet ishin një dhimbje, sepse hera-herës do t’i bëheshin me vrima. Përveç kësaj, përse i veshim të dyja, edhe çorape, edhe këpucë, kur njëra prej tyre do ishte për bukuri?

Violina dhe Ajnshtajni


Paulina, nëna e Ajnshtajnit, ishte një pianiste profesioniste dhe donte që djali i saj të donte edhe muzikën, prandaj i filloi mësimet e violinës që kur ishte gjashtë vjeç. Për fat të keq, në fillim, Ajnshtajni urrente t’i binte violinës. Preferonte më shumë të ndërtonte shtëpi me letra, gjë të cilën e bënte vërtet mirë.

Në moshën 13 vjeçare, kur dëgjoji muzikën e Moxartit ndryshoi mendim rreth violinës. Me një pasion të ri për të luajtur, Ajnshtajni vazhdoi t’i binte violinës deri në vitet e fundit të jetës së tij.

Për gati shtatë dekada, Ajnshtajni do ta përdor violinën për t’u çlodhur kur ndjehej i bllokuar në procesin e të menduarit, si dhe do të luante në recitalet lokale ose do të bashkohej me grupet e improvizuara si kremtimet e Krishtlindjeve, të cilët ndaleshin para shtëpisë së tij.



MËLÇIA SI ORGANI MË I MADH NË TRUPIN E NJERIUT DHE ROLI SAJ NË PASTRIMIN E TRUPIT



Mëlçia është organi qendror i gjithë metabolizmit dhe gjënda më e madhe e trupit që lidhet me aparatit tretës. Detyrat më të rëndësishme të saj janë *prodhimi i proteinave të rëndësishme për jetën (p.sh faktorët e mpiksjes)*, përpunimi i pjesëve përbërëse të ushqimit (*p.sh ruajtja e glukozës*), prodhimi i lëngut të tëmthit dhe kështu tretja dhe eliminimi i produkteve të metabolizmit të trupit si dhe e medikamenteve dhe helmeve. Substancat ushqimore, të cilat kalojnë nga zorra në gjak, mbërrin në anë të venës *Vena portae* në mëlçi dhe mandej varësisht nga nevoja lëshohen nga mëlçia përsëri në gjak ose largohen nga gjaku.

Mëlçia e njeriut peshon përafërsisht 1500 deri 2000 g. Është një organ i butë me strukturë të njëtrajtshme dhe gjendet

kryesisht në anën e djathtë të pjesës së sipërme të hapësirës së barkut.

Mëlçia është lidhur ngushtë me drejtimin dhe funksionimin e saktë të metabolizmit të glukozës, yndyrës dhe proteinave. Glukoza merret nga gjaku i zorrës dhe i jepet trupit në mënyrë të kontrolluar. Teprica deponohet si *glikogjen*. Gjatë urisë bëhet përsëri shpërbërja e substancës së deponuar në glukozë. Mëlçia ndikon, e drejtuar nga *hormonet* (*p.sh insulina dhe glukagoni*) në pasqyrën e *sheqerit* në gjak dhe mund ta mbajë atë në një shkallë konstante pavarësisht nga marrja e ushqimit. Insulina aktivizon në mëlçi *oksidimin* e sheqerit dhe pengon shpërbërjen e yndyrës.

Simptoma të sëmundjeve të mëlçisë

Verdhëza, gjakderdhje nga varicet e ezofagut, krijimi i ujit në hapësirën e barkut, dobësi të kujtesës, hutim.

Simptomat të cilat tregojnë punën e ngadalësuar të mëlçisë.

- Shpesh vjen deri te lodhja, madje edhe me rastin e mundimeve minimale fizike.
- Shfaqen dhembje të kokës, të cilat manifestohen në gropat e syve.
- Shfaqen dhembjet në nyja dhe muskuj.
- Shfaqet djersitje e shtuar, sepse trupi nxjerr jashtë toksinet të cilat mëlçia nuk mund t'i përpunojë.
- Shfaqen probleme me lëkurën në formë të akneve dhe ekzemave, sepse vjen deri te grumbullimi i bashkimeve toksike, të cilat mëlçia nuk i ka përpunuar por që i ka nxjerrë jashtë.
- Shpesh shfaqen alergji, sepse toksinet grumbullohen në organizëm.
- Shfaqen probleme me kapsllëkun apo me vjelljen, ndërkaq këto përcillen me dhembje stomaku, siç ndodhin edhe fryrjet.
- Ekziston problemi me shtimin e peshës, edhe pse nuk futet në organizëm shumë ushqim.
- Shfaqen problemet me tretjen e ushqimit të yndyrshëm.
- Shfaqet erë e keqe. Shfaqet disbalanca hormonale, sepse mëlçia nuk mund të eliminojë tepricën e hormoneve.
- Koncentrimi është i vështirë,

ndërkaq obligimet mendore paraqesin mundim të madh.

• Është e mundshme që t'u shfaqet depresioni, edhe pse nuk keni qenë të ekspozuar traumave apo ngjarjeve të cilat do kishin të mundur ta shkaktonin atë.

Shfaqet ndjenja e shqetësimit, sepse krijohet përshtypja që do të ndodhë diçka e keqe.

Detoksifikimin e mëlçisë më së miri do ta arrini me të ushqyer me ushqim të pasur *me pemë dhe perime, me vaj ulliri, peshk dhe me proteina bimore dhe shtazore.*

Fatkeqësisht disa lloj ushqimesh që hamë e dëmtojnë mëlçinë. Si mund të ndihmojmë në rigjenerimin e mëlçisë së dëmtuar?

Lajm i mirë është se ka shumë ushqime që mund të ndihmojnë në pastrimin e

mëlçisë në mënyrë që të jetë në gjendje të funksionojë më mirë.

Qitro

Qitro përmban vitaminë C me shumicë si dhe pektinë e cila ndihmon në procesin

e pastrimit të mëlçisë. Ky frut përmban antioksidantë të njohur si glutathione që mund të ndihmojnë në luftën kundër radikaleve të lira të cilat mund të ngadalësojnë punën që bën mëlçia.



Mund ta konsumoni qitron si lëng ose vakt të ndërmjetëm për të ushqyer trupin dhe për të mbrojtur mëlçinë gjithashtu.

Avokado

Një tjetër superushqim që mund të shtoni në dietën tuaj për të ndihmuar mëlçinë është avokado. Glutathione i pranishëm në këtë frut është në gjendje të eliminojë toksinat e pranishme në trup në mënyrë që mëlçia të jetë në gjendje të funksionojë më mirë.

Një tjetër anë pozitive e avokados është se përmban nivele të larta yndyrash të pangopura të cilat mund të zvogëlojnë sasinë e kolesterolit të keq në trupin tuaj dhe të rrisin nivelet e HDL (kolesterol i mirë).

Limoni

Gjithmonë ka një arsye pse duhet të shtoni limonë në dietën tuaj dhe një prej tyre është detoksifikimi i mëlçisë duke aktivizuar enzimat me ndihmën e antioksidantit D-Limonene. Meqenëse limoni është i njohur për përmbajtjen e lartë të vitaminës C, rrit sasinë e enzimave që prodhohen në mëlçi për të mbështetur tretjen.

Një tjetër përfitim është se limonët mund të ndihmojnë në përthithjen e mineraleve gjithashtu. Ju mund të shtoni lëngun e limonit në një kavanoz me ujë dhe ta pini sa herë që dëshironi. Nëse shija nuk ju pëlqen, mund të shtoni pak mjaltë.

Arrat

Shtimi i arrave në dietën tuaj është një ide e shkëlqyer, sidomos kur mëlçia juaj nuk funksionon mirë. Ato janë të pasura

me L-argininë e cila detoksifikon mëlçinë nga amoniaku.

Ngrënia e arrave mund të ndihmojë në rritjen e sasisë së acideve yndyrore omega-3 në trupin tuaj dhe madje të shpërndajë glutathione, i cili ndihmon mëlçinë të largojë toksina në të.

Panxhar i kuq

Nuk duhet të harroni të shtoni panxhar në dietën tuaj pasi është një superushqim për mëlçinë tuaj. Ai përmban beta karoten dhe flavonoide të cilat mund të stimulojnë mëlçinë tuaj.

Mund të ndihmojë gjithashtu në pastrimin e gjakut i cili i bën mirë mëlçisë.

Çaji i gjelbër

Një mënyrë tjetër për të pastruar trupin nga toksina është çaji jeshil. Përmban sasi të larta të katekineve të cilat forcojnë katobilizimin e lipideve në mëlçi të cilat ndihmojnë në parandalimin e yndyrave në këtë organ. Një tjetër plus është se ai mund të trajtojë dhe parandalojë gjithashtu problemet e mëlçisë.



Depresioni dhe vuajtja e brendëshme

BUZËQESHJA DEPRESIVE

Cfarë është buzëqeshja depressive?

Buzëqeshja është shpesh një fasadë e jashtme dhe mekanizëm mbrojtës

Termi *buzëqeshja depressive* nënkupton personat që shfaqen të lumtur për të tjerët, ndërkohë që vuajnë nga brenda.

Këto simptoma depressive janë bërë gjithnjë e më të shpeshta. Artikujt lidhur me këtë temë janë ngritur në literaturën popullore, dhe numri i



kërkimeve në Google për gjendjen është rritur në mënyrë dramatike këtë vit.

Simptomat e depresionit duken të lehta për t'u dalluar: interesi për gjërat që deshëm dikur ulet, humori ndryshon brenda pak kohësh, dëshirë e paparë për të ngrënë gjithçka ose ekstremi tjetër, mungesë e theksuar urie.

Gjithsesi, ka diçka?! Ndonjëherë t'i nuk i dallon dot këto që përmendëm më sipër, jo sepse nuk janë aty, por sepse zgjedh t'i fshehësh edhe nga vetja.

Ndoshta ndjen që i ke gjithë simptomat më lart, por sërish vazhdon jetën normalisht: shkon në punë, del me miqtë apo familjarët dhe je gjithnjë me një buzëqeshje në fytyrë.

Nga mjekësia kjo njihet si *depression i qeshur*. Deri diku tingëllon paradoksale, por ç'është në të vërtetë buzëqeshja depressive?

Njerëzit herë pas here përpiqen ta kamuflojnë duke i vendosur pikërisht këtë maskë

simptomave që po përjetojnë. Ata ngrihen çdo mëngjes, vishen, shkojnë në punë dhe vazhdojnë të ndërveprojnë m të tjerët pavarësisht si ndihen nga brenda.

Kjo lloj buzëqeshjeje është në vetvete një emër tjetër për të quajtur depresionin- ose një mërzitje kronike që ndikon në çrregullimin e gjumit, ndryshimet e oreksit apo ndjesi të tjera si frikëra apo atake paniku.

Pse s'kishim dëgjuar kurrë për këtë lloj buzëqeshjeje?

Në fakt ky nuk është një term që ekziston, por ekspertët e përdorin për t'i bërë njerëzit të kuptojnë gjendjen aktuale të tyre dhe të kërkojnë ndihmë.

*Si ta kuptojmë nëse kemi një **buzëqeshje depressive** ose jo?*

Nuk ka një përgjigje të saktë për këtë, por janë shumë shenja dhe simptoma nga të cilat mund t'i kuptojmë. Nëse ndiheni pa energji, çdo ditë është e njëjta gjë dhe s'e kuptoni pse, kjo do të thotë që ka diçka që s'shkon me gjendjen tuaj emocionale.

Trajtimi mund të fillojë me pranimin e hapur të problemit

Ashtu si shumica e çrregullimeve, depresioni i qeshur është gjithashtu i shërueshëm. Përveç këshillimit profesional ose psikoterapisë, trajtimi mund të fillojë me pranimin e hapur të problemit. Zgjidheni një anëtar të ngushtë të familjes ose ndonjë mik të afërt, dhe flisni për ndjenjat tuaja. Ideja është që ta largoni

ngarkesën e tepërt, gjë që mund të ndihmojë në lehtësimin e simptomave të depresionit. Diskutimi i hapur dhe ndarja e ndjenjave është një element kyç në luftën me mendimet depressive.

Nuk e përjetojmë të gjithë depresionin në të njëjtën mënyrë. Disa nuk e dinë se janë në depresion dhe ata mund t'i shohim duke qeshur dhe në të njëjtën kohë pa vullnet. Njerëzit e tillë shoqërohen me dëshirë dhe paraqiten në ngjarje, por përbrenda janë të prekur nga gjendja depressive. Shpesh ndodh që personi i cili vuan nga kjo formë e çrregullimit, nuk dëshiron as vetes dhe as mjedisit t'ia pranojë se e mundon diçka dhe përpiqet ta fshehë atë. Buzëqeshja është shpesh një fasadë e jashtme dhe mekanizëm mbrojtës. Pikëllimin mund ta ndiejmë për shkak të marrëdhënies së dështuar, karrierës së dështuar apo mungesës së motivimit për jetën. Pikëllimi mund të jetë një shenjë e qartë se diçka nuk është në rregull.



A e njihni dikë që vazhdimisht është duke qeshur, ndërsa në thelb është person depresiv? *Personat depresivë* zakonisht prezantohen si persona që janë të lidhur për shtrati dhe të pikëlluar. *Depresioni* është një çrregullim i rrënjosur thellë në histori, ndërsa në kohët moderne është një fenomen në rritje.

Simptomat e tjera të zakonshme të depresionit janë *anksioza, frika, zemërimi, lodhja, nervozizmi, humbja e shpresës dhe dëshpërimi*. Ata që vuajnë nga këto dhe forma të tjera të depresionit, mund të kenë probleme me

gjumin, mungesë të argëtimit në aktivitete të përditshme dhe humbje të dëshirës seksuale. Eksperiencat me depresion janë të ndryshme, ndërsa është e mundur të ndiejnë vetëm një ose më shumë simptoma.

Personat që vuajnë nga depresioni i qeshur,




shpesh nuk e shfaqin asnjë tregues të problemeve me botën e jashtme. Ata kanë punë të qëndrueshme, e krijojnë familjen, marrin pjesë në sporte dhe e kanë një jetë mjaft aktive shoqërore. Nën maskë ata vuajnë nga pikëllimi, sulmet e panikut, vetëbesimi i ulët, pagjumësia dhe, në disa raste, mendime vetëvrasjeje.

Ashtu si shumica e çrregullimeve, depresioni i qeshur është gjithashtu i shërueshëm. Përveç këshillimit profesional ose psikoterapisë, trajtimi mund të fillojë me pranimin e hapur të problemit. Zgjidheni një anëtar të ngushtë të familjes ose ndonjë mik të afërt, dhe flisni për ndjenjat tuaja. Ideja është që ta largoni ngarkesën e tepërt, gjë që mund të ndihmojë në lehtësimin e simptomave të depresionit. Diskutimi i hapur dhe ndarja e ndjenjave është një element kyç në luftën me mendimet depressive.

POEZI

Vorea Ujko

**" NË AEROPORT "**

Gusht i vonuar. E unë
 i kredhur në zhegun
 e aeroportit të Tiranës
 shijoja një ditë fëmijnije
 duke kërkuar fillin e bjerrë.
 Nga pista e fluturimit
 një zë më thirri:
 Mirë se vjen vëlla Vore!
 Prej kah vinte ai zë?
 Ishte vallë zëri i babës
 apo zëri i vëllait?
 Të dallova e m'u duke
 një shtegtar udhëtimesh të gjata
 nën qiej të shndritshëm.
 Dëgjova përshëndetjen e ngrohtë
 dhe pashë fytyrën e butë
 ku lexova sihariqe të sigurt.
 Nga sa mot ne u kishim ndarë?
 Oh, rrahje zemre!
 Askurrë s'kam qenë ashtu i lehtë
 në hovin tim të pastër.
 E më rrethuan krahë.
 brenda një rrethi vllazërie.
 Pastaj vrapuam drejt Tiranës
 dhe e ndjeva veten një zog
 me cicërima dielli në gjoks.
 Gra të gëzueshme nëpër fusha
 i buzëqeshnin birit që kthehej.

Martin Camaj

**"MBRAMJA ASHTË LARG"**

Mbramja ashtë larg
 e ti je atje mbi kodër të blerueme
 ku gurzit që bashin zhurmë
 i përpiu dheu.

Ti je atje me të bijën e heshtjes
 e me shoqe tjera e mendon për mue.
 Unë jam në detin e tingujve

e ndër gjujt e mij ndieva
 peshen e tramit tue u ndalue me turr.
 Mandej i lëshova vendin një të vjetri
 e mes tallazit të krahve thashë:
 mbramja ashtë larg e ti andej lumit.

Heshtja prek qiellin me dorë
 E ti atje mbi kodër të blerueme
 njeh gjurmët e diellit npër qiell.

POEZI


Azem Shkreli



**"Përshëndetje me Miq
(Ismail Kadaresë)"**

Plot fjala është me ju, plot kupa, plot gjiri i nënës
Kudo e ngado është e juaja pos mohit, pos orës së prapë
Dhe krismës prapa shpinës, po unë me se të ju zbukuroj
në baladë, o miq, me se, o dega ime e epër e fisit,
Atij tisi të hollë e tisi të rrallë, tri herë të zier
Në ashtin tuaj e timin, po unë me se të ju kem, me se-
Të ju përyjnoj, e vetëm ju e dini atë bar të mirë
Atë lëng rrëzë fjale me të cilin m'i mëkoni plagët
Ethet e qentë m'i përzeni kur kam zjarrmi, kur digjem
Ujë etjes m'i jepni bri kroit të Martinit e bri Kruje
Ullirin e moshës ma piqni, zotynë shëndet iu dhashtë
Nga jeta e vet e popullit, nga gjaku, nga shpendi ynë
Ju dhashtë, me se të ju di, me se të ju zbukuroi në baladë,
e jeni sa krip ka koka, sa fij bari, sa deti, Alkal
Me Alkal ju dëgjoj e më ktheni me mallë në shtizë

Dritëro Agolli



"Kur të Jesh Mërzitur Shumë"

Këtu s'do të jem, do jem larguar;
Nën tokë i tretur si të tjerët,
Në kafenenë e preferuar
Nuk do më shohin kamarierët.

Dhe nëpër udhët ku kam ecur,
S'do ndihet kolla ime e thatë,
Mbi varrin tim do të rrijë i heshtur
Një qiparis si murg i ngratë.

Ti do trishtohesh atëherë,
Se s'do më kesh në dhomë të gjallë,
Dhe, kur në xham të fryje erë,
Do qash me erën dalëngadalë.

Po kur të jesh mërzitur shumë.
Në raft të librave kërkomë,
Atje i fshehur do të jem unë,
Në ndonjë varg a ndonjë shkronjë

Mjafton që librin pak ta heqësh
Dhe une do zbres, do vij pas teje;
Ti si dikur me mall do qeshësh,
Si një blerim pas një rrekeje.

ORIGJINA E FOLKLORI MUZIKOR SHQIPTAR

Muzika popullore është muzika tradicionale, zhanëri që evoloi prej saj gjatë ringjalljes popullore të shekullit XX. Disa lloje të muzikës popullore mund të quhen muzikë botërore. Muzika tradicionale popullore është përcaktuar në disa mënyra: si muzikë që transmetohet gojarisht, muzikë me kompozitorë të panjohur, ose muzikë e realizuar me porosi për një periudhë të gjatë kohore. Ka qenë në kontrast me stilet tregtare dhe klasike. Termi e ka zanafillën në shekullin XIX, por dihet që muzika popullore shtrihet përtej kësaj.

Duke filluar nga mesi i shekullit XX, një formë e re e muzikës popullore evoluoi nga muzika popullore tradicionale. Ky proces ashtu si edhe periudha quhet kushtimisht ringjallja e dytë popullore e që arriti zenitin në vitet '60. Kjo formë e muzikës nganjëherë quhet muzikë popullore bashkëkohore ose muzikë folklorike për ta dalluar atë nga format më të hershme popullore.

Ringjallje më të vogla, të ngjashme kanë ndodhur diku tjetër në botë, në periudha të tjera, por termi muzikë popullore nuk është

përdorur zakonisht për muzikën e re të krijuar gjatë atyre periudhave. Ky lloj i muzikës popullore përfshin gjithashtu edhe zhanre të tilla si fusion, rock folk, folklorik, etj. Ndërsa muzika popullore bashkëkohore është një zhanër në përgjithësi i dallueshëm nga muzika popullore tradicionale, në anglishtën amerikane ajo ka të njëjtin emër, dhe shpesh ndan të njëjtët performues dhe ambiente ashtu si edhe muzika popullore tradicionale. Termat muzikë popullore, këngë popullore dhe vallëzim popullor janë shprehje relativisht të vonshme. Ato paraqesin një shtrirje ose zgjerim të kuptimit të termit folklor, që u krijua në vitin 1846 nga antikuari anglez William Thoms për të përshkruar "traditat, zakonet dhe besëtytnitë e klasave të pakulturuar".

Termi rrjedh më tej nga shprehja gjermane *volk*, në kuptimin e "popullit në tërësi", siç zbatohet për muzikën popullore dhe kombëtare nga Johann Gottfried Herder dhe romantikët gjermane afër një shekull më parë.

Megjithëse kuptohet që muzika popullore është muzikë e popullit, vëzhguesit ende gjejnë



përcaktime të paqarta dhe të pakapshme. Disa madje as nuk janë dakord se duhet të përdoret termi muzikë popullore. Muzika popullore mund të ketë tendencë për disa karakteristika të caktuara por nuk mund të diferencohet qartazi në terma thjesht muzikorë. Një kuptim që jepet shpesh është ai i "këngëve të vjetra, pa kompozitorë të njohur", tjetër është ajo e muzikës që i është nënshtruar një procesi evolucionar "të transmetimit oral ... të modës dhe rimodelimit të muzikës nga komunitetet që i japin asaj karakterin e tij popullor". Përkufizime të tilla varen më shumë nga proceset "(kulturore) sesa nga llojet abstrakte muzikore ...", nga "vazhdimësia dhe transmetimi oral... shihet se karakterizon një rëndësi anë të një dikotomie kulturore, pala tjetër e së cilës gjendet jo vetëm në pjesën e poshtme të feudalizmit, kapitalizmit dhe të disa shoqërive orientale por edhe në shoqëritë 'primitive' dhe në pjesë të 'kulturave popullore'". Një përkufizim i përdorur gjerësisht është thjesht "Muzika popullore është ajo të cilën e këndojnë njerëzit (populli)".

Muzika popullore Shqiptare përbën një ndër pasuritë më të çmuara të vendit. Në përshkrimet e studiuesve të huaj të ardhur në Shqipëri gjatë shekujve XVIII-XIX është arritur përafërsisht në konkluzionin se pasuria kryesore e Shqipërisë është *folklori muzikor*.

Folklori muzikor bën një jetë aktive edhe sot, ndërkohë që gjurmët e lashtësisë së tij janë provuar që prej shekujve XIV-XIII p.e.s. Në objekte të ndryshme arkeologjike – skulptura, basoreliefe, terrakota, etj. – janë përfiguruar qartë *vegla popullore*, që përdoren deri në ditët tona, *valltarë, këngëtarë, kostume karakteristike*, etj.

Folklori muzikor shqiptar është jashtëzakonisht i pasur, çka dhe shprehet në ekzistencën e *muzikës vokale* që nga forma njëzërëshe e deri tek shumëzërëshi; në muzikën me vegla popullore; muzikën me zë e vegla; muzikën për shoqërimin e valleve popullore, etj. Këtyre

u shtohet dhe një fond i madh veglash popullore të klasifikuara në katër grupet tashmë të njohura si ideofone, membranofone, kordofone, areofone.

Folklori muzikor shqiptar e bën jetën e vet në një ndarje specifike, që lidhet me format e të shprehurit muzikor dhe me tipet kryesore të instrumenteve të përdorur. Lumi i Shkumbinit, që përshkon mes për mes Shqipërinë, përvecse ndan dy dialektet kryesore të vendit në Gegë në Veri të Shkumbinit dhe në Toskë në Jug të *Shkumbinit*, shërben edhe si kufi natyror për klasifikimin e tipologjisë së folklorit muzikor. Në veri të lumit Shkumbin lokalizohet zona monodike e të shprehurit muzikor, e shoqëruar kjo me shkallët modale (diatonike apo kromatike) sëbashku me vegla muzikore specifike për këtë zonë, si *lahuta* dhe *çiftelia*. Ndërkohë, për trevat që shtrihen në jug të lumit Shkumbin është karakteristik fenomeni i të shprehurit muzikor në iso-polifoni (ang. Poliphonie with burdon) me përdorimin e shkallëve pentatonike si dhe të instrumenteve specifik si gajde dhe bicula (fyell i dyfishtë). Krahas muzikës fshatare pa shoqërim me vegla (a capella), duke nisur nga fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë, lindi dhe u kristalizua muzika popullore qytetare, që në Jug të Shqipërisë takohet kyesisht në qytetet Korçë, Vlorë, Sarandë, Delvinë, Përmet, Leskovik, Pogradec, me formacionin polifonik të Sazeve (të përbërë nga instrumente të importuar si klarineta, violina dhe fizarmonika, si dhe nga vegla popullore karakteristike si lahuta, dajre, fyell), ndërsa në Veri në qytetet Shkodër, Durrës, Elbasan, Kavajë, etj., shoqëruar nga ansamble popullore monodike ose monodi me shoqërim (të përbërë nga vegla të importuara si klarineta, fizarmonika dhe violina, por edhe nga vegla të traditës popullore, si kemanxhia, fyelli, etj).

Nisur nga roli i dorës së parë që ka në traditën shqiptare, folklori muzikor studjohet si lëndë e veçantë në shkollat e mesme të përgjithëshme,

në ato artistike, si edhe në Akademinë e Arteve të Tiranës, ku formohen edhe etnomuzikologët e ardhëshëm.

Regjistrimet e folklorit muzikor shqiptar nisin që prej viteve 1900 e këtej. Përpara viteve 1940 ato janë realizuar pranë shoqërive *Odeon, Colombia, Pathé, His master's voice*. Regjistrime më të vona takohen edhe në formën e CD-ve, si CD me muzikë të “Familjes Lela”, prodhuar në Francë më 1992 nga Judigo; dy CD me muzikë toske të “Laver Bariut”, prodhuar përkatësisht në Greqi dhe Angli, etj.

Gjatë viteve 1950-1990 tradita e re muzikore shqiptare bëri hapa të rëndësishëm përpara, duke ezauruar në një mënyrë apo një tjetër vonesën e gjatë në kohë. Repertori muzikor shqiptar plotësohet me të gjitha format e gjinitë tradicionale, që nga ato të muzikës së dhomës e deri tek ato skenike. Një rol përcaktues për këtë luajti ngritja për të parën herë në Shqipëri e institucioneve të tilla të rëndësishme muzikore, si **Filarmonia e**



Shtetit, Teatri i Operas dhe Baletit, disa orkestra sinfonike dhe ansamble korale në Tiranë dhe në qytete të tjera të vendit, si **Shkodër, Korçë, Vlorë, Elbasan, Durrës**, si dhe krijimi i sistemit të plotë të edukimit muzikor.

Zhvillimet muzikore shqiptare të kohës pësuan një rritje të ndjeshme që prej gjysmës së dytë të viteve 1960 me Koncertet e Majit të Tiranës, të cilat u mbajtën në mënyrë periodike nga viti 1967 deri më 1990 duke aktivizuar muzikantë

e trupa profesioniste dhe amatore. Përgjithësisht muzika e kësaj periudhe ka një orientim tradicional klasiko-romantik dhe një mbështetje të fortë në folklorin muzikor shqiptar. Përvec *Zadesë* dhe *Jakovës*, disa nga



figurat kryesore të muzikës shqiptare të gjysmës së dytë të shekullit XX janë *Tish Daija (1926)*, *Nikolla Zoraqi (1929-1991)*, *Tonin Harapi (1928-1991)*, *Feim Ibrahim (1935-1997)*, *Shpëtim Kushta (1946)*, *Thoma Gazi (1948)*, etj. Në kushtet e izolimit të vendit, muzika shqiptare e kësaj periudhe, ashtu si të gjitha artet në përgjithësi, me përjashtim të përpjekjeve të rastit, e pati të pamundur avancimin drejt zhvillimeve bashkëkohore perëndimore.

Mbas viteve 1990 situata muzikore në Shqipëri njohu zhvillime krejtësisht të reja, të cilat synuan integrimin e shpejtë në strukturat artistike europiane. Një rol të rëndësishëm për këtë luajti formimi i shoqatave muzikore, si Shoqata e Muzikës së re Shqiptare (NAM, anëtare e Konferencës Europiane të Muzikës së Re) dhe Shoqata Mbarëshqiptare e Profesionistëve të Muzikës (seksioni shqiptar i ISCM), pranë të cilave është grumbulluar pjesa dërrmuese e kompozitorëve dhe interpretesve të vendit, dhe që aktualisht shërbejnë si tribuna kryesore të krijimtarisë së re muzikore të kompozitorëve shqiptarë.

KINEMATOGRAFIA SHQIPTARE DHE XHIRIMI I FILMIT TË PARË TË SKENDERBEUT

Kinostudio *Shqipëria e Re* u themelua në vitin 1952. Realizimi i parë i saj është bashkëprodhimi shqiptaro-rus filmi "*Skënderbeu*". Ky është i pari realizim "kolosal" i prodhuar nga kjo studio kinematografike. Në vitin 1957 prodhohet filmi i parë i një regjisor shqiptar, Hysen Hakani. Prodhimet në masë fillojnë rreth viteve '70, periudhë që korenspondon uljen e numrit të filmave të importuar.



Në vitet '80 Kinostudio "*Shqipëria e Re*" prodhon rreth 14-15 filma në vit, tematikat janë nga më të ndryshmet. Ndryshimi i sistemit politik dhe kriza ekonomike e viteve '90 sjell transformimin e saj në "**Albafilm**" dhe në vitin 1996 edhe kjo e fundit mbyll ekzistencën e saj. "*Shqipëria e Re*" lë në trashëgim rreth 200 filma, kuptohet një pjesë të cilëve ishin prodhim i propagandës shtetërore, filma për nga teknika në krahasim me Hollyëoodin të dobët, por në krahasim me vendet përreth të kënaqshëm. Por ajo lë në trashëgim

edhe një sasi të konsiderueshme filmash dhe aktorësh, që kanë qenë pjesë e jetës kulturore te shumë breza shqiptarësh.

Kinematografia në Shqipëri u zhvillua mbas vitit '45, ndërkohë që si shfaqje e parë filmike njihet ajo e piktorit Kol Idromenos në vitin 1912. Filmi më i vjetër me temë shqiptare i xhiruar nga të huajt, është "*Albania ribelle*", xhiruar nga shoqëria italiane "*Cines*" e Torinos, në vitin 1909. Në vitin 1946 u ngrit ndërmarrja e parë kinematografike shqiptare. Gjatë viteve '70- '80-'90 prodhimi kinematografik shqiptar numëronte në vit, **14 filma artistikë**, 40 dokumentarë dhe kronikalë, 16 filma vizatimorë të teknikave të ndryshme. Filmi hyri në Shqipëri në vitet 1911-12. Shfaqjet e para publike u dhanë në qytetet **Shkodër e Korçë**. Sallat e para te kinemave si institucione publike u ngritën me iniciativën private pas Luftës I Botërore, në qytetet Vlorë, Korçë, Tiranë, Shkodër, Berat. Filmat e parë u bënë nga të huajt, ata qenë kronika.

Kronika e parë për ngjarje të lidhura me Shqipërinë është ajo e lidhur me Kongresin e Manastirit (1908), që sanksionoi Alfabetin e gjuhës shqipe. Pas viteve '90, prodhimi i filmit shqiptar ka shënuar rënie të

ndjeshme. "Tana" është film i parë artistik shqiptar me metrazh të gjatë. Prodhim i Kinostudios "Shqipëria e re", realizuar në vitin '1958. Subjekti i filmit, me temë nga jeta shoqërore e fshatit, është realizuar me skenar të Fatmir Gjatës, mbështetur në novelën e tij me të njëjtin titull. Regjisor është Kristaq Dhamo. "Qeshim se nuk qajmë dot" është filmi i parë artistik me metrazh të shkurtër, me regjisor Viktor Stratobërdha, me skenar të Dionis Bubanit. U shfaq për herë të parë pas 43 vjetësh, në vitin 1999, për shkak se regjisori Stratobërdha u dënua nga regjimi komunist. "*Beni ecen vete*", film artistik për fëmijë me regjisore Xhanfise Keko (Artiste e Popullit), prodhim i vitit 1975, ka fituar çmimin e posaçëm në festivalin për fëmijë të Salernos në Itali në vitin 1979. "Zana dhe Miri", është filmi i parë vizatimor i prodhuar në vitin 1975. Më pas, filloi prodhimi i filmave me teknikën e vizatimit dhe më vonë i filmave me teknikën e kombinuar me sende reale.

Kinematografia Shqiptare përfshin gjithë kinematografinë e zhvilluar në territoret *e banuara nga popullsia shqiptare*, pra kinematografinë e shtetit të **Shqipërisë**, të **Kosovës**, të **Maqedonisë së Veriut**, të **Çamërisë (Greqi)** dhe **Malit të Zi**. Gjithashtu vlen të përmenden edhe arritjet në kinematografi të popullsive shqiptare arbëreshë në Itali dhe arbëreshë në Greqi. Kjo kinematografi ka prodhuar

filma në gjuhën shqipe apo ka prodhuar ose bashkëprodhuar filma në gjuhë të tjera, sipas shteteve përkatëse por ku pjesë në një masë të konsiderueshme kanë qenë edhe krijues, teknikë, regjizorë, aktorë etj. me etni shqiptare.

Duke qënë popullsia shqiptare e ndarë në shtete të ndryshme edhe zhvillimi i kinematografisë, sidomos pas copëtimit të madh të vitit 1912, ka ndjekur ritme të ndryshme sipas dinamikave të shteteve ku popullsia shqiptare bënte pjesë. Në përgjithësi mund të thuhet se përveç shtetit të Shqipërisë prodhimi i filmave në gjuhën shqipe ka qenë shumë më i vonuar në shtetet e tjera. Kjo pasi politikat asimiluese nuk përkrahnin një zhvillim të artit dhe kulturës në gjuhën shqipe, përkundrazi ishin të prirura ta luftonin.



Trungu i kinematografisë shqiptare paraqitet me katër e degëzimet e saj të mëdha: *Filmi kronikë*, *Filmi dokumentar*, *Filmi artistik* (ose *Kino film* në Kosovë) dhe *Filmi i animuar*. Menjëherë pas *Luftës së Dytë Botërore* u krijua nga shteti *Agjencia Shqiptare e Filmave* (1945), e cila më

pas u shndërrua në Ndërmarrje Shtetërore Kinematografike Shqiptare (1947), kohë kur u bë shtetëzimi i plotë i rrjetit të sallave, importit, dhe prodhimit. Nisi xhirimi i filmave kronikalë, dhe në maj të vitit 1948 u shfaq kinokronika e parë shqiptare. Në një vend me përqindje të lartë të analfabetizmit në vitet '40-'50, shteti i dha rëndësi shtimit të numrit të sallave dhe aparateve lëvizës, si dhe importit të filmave kryesisht nga vendet e Europës



Lindore, Franca e Italia.

Me kalimin e viteve e tjerë, veçmas në vitet 50 të shekullit të kaluar lindi nevoja e zhvillimit të kinematografisë vendase sepse në të shumtën e rasteve në Shqipëri kane xhiruar të huajt, italianë, rusë e të tjerë. U dërguan student në shkollat kinematografike në Rusi, Çeki dhe Hungari. Prej këtyre shkollave erdhën kuadrot e para që krijuan premisat për krijimin e qendrës kinematografinë me emrin "Kinostudio Shqipëria e Re" një titull ky që i përshtatej euforisë së sistemit që pretendonte të krijonte çdo gjë nga e para duke shembur çdo gjë të së kaluarës. Kronikat e para të xhiruara

nga operatorët shqiptarë janë evenimentet e ndryshme që ndodhnin në vitet 50 në Shqipëri në periudhën e rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta. Përvoja në filmat dokumentar solli edhe hapa të tjerë në krijimin e sektorit për prodhimin e filmave artistikë.

Filmi Skënderbeu një bashkëpunim shqiptaro-sovjetik do të shënonte hapin e parë. Në vitet 70 të shekullit të kaluar u dërguan edhe kuadro për tu specializuar në Rumani për filmin vizatimor Vlash Droboniku dhe Tom Vaso të cilët e prodhuan filmin e parë Zana dhe Miri.

Kinemaja shqiptare sot

Sot kinemaja shqiptare përjeton një periudhë të vështirë tranzicioni e përshtatjeje me ekonominë e tregut. Përveç rënies së prodhimit në sasi edhe rrjeti i sallave të kinemave ka zbritur ndjeshëm, dhe vetëm kohët e fundit janë bërë dhe po bëhen përpjekje për ngritje sallash të reja bashkëkohore si kinemaja "MILLENIUM" në Tiranë dhe një tjetër në Elbasan. Nga ana tjetër, forcat krijuese janë të shumta dhe entuziaste, të çliuara nga trysnia totalitare, dhe ekonomike e përqendruar, si dhe me iniciativë private përherë në rritje. Mund të thuhet se kinemaja shqiptare sot ndodhet midis nostalgjisë së një kinemaje kombëtare, të lindur e zhvilluar në kushte të caktuara, dhe së ardhmes në ndërtim e sipër.

Shkolla dhe fëmijët

BULLIZMI NË SHKOLLË

Bullizmi është një *dhunë psikologjike* ose *fizike*, e cila ndodh masivisht në të gjitha shtetet e botës, duke filluar me fëmijët që në bankat e para të shkollës.

"Dhuna në mjediset e shkollës (në të gjitha format e saj) është një shkelje e të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve për arsim, shëndet dhe mirëqenie". Asnjë shtet nuk mund të arrijë një edukim cilësorë gjithëpërfshirës dhe të barabartë, nëse nxënësit përjetojnë dhunë apo bullizëm në shkollë" - shkruhet në raportin "Pas shifrave: "Fund dhunës në shkolla dhe bullizmit" që ka publikuar UNESCO në janar 2019.



Shenjat e bullizmit te fëmijët

Bullizmi dallohet te fëmijët kur:

- *Fëmija ka shenja të ndryshme në trup dhe nuk di ti shpjegojë.*
- *Fëmija kërkon para PA ndonjë arsye të bindshme.*

- *Fëmija nuk dëshiron të shkojë në shkollë apo nuk ka dëshirë të luajë me miqtë e tij.*
- *Fëmija dëshiron që të ndryshojë mënyrën e të shkuarit në shkollë dhe kur ai do të ndërrojë partnerin e rrugës.*
- *Fëmija vjen vonë nga shkolla.*
- *Fëmija ka dëme materiale si çanta.*

Bullizmi si fenomen shoqëror po bëhet gjithnjë e më shqetësues, jo vetëm për fëmijët, por dhe për prindërit për komunitetin, sepse fëmijët që preken nga bullizmi, janë reflektimi i të sotmes dhe përcaktues i të nesërmës në shoqëri.

Bullying është një term psikologjik i kohëve të sotme që i shqipëruar do të thotë "kërcënim" dhe tregon fenomenin e sjelljeve të përsëritura, agresive, të dhunshme me karakter psikologjik, fizik, që ju bëhet fëmijëve adoleshentëve të pambrojtur të vetmuar, nga një individ ose grup individësh të tjerë edhe këta njësoj moshatar ose më të mëdhenj të cilët kërkojnë të diskriminojnë, keqtrajtojnë, abuzojnë me bashkënxënësit si ata nëpër shkolla.

Këta individ ose grup agresiv kryejnë bullizëm ndaj “viktimave” të tyre duke gjetur shkak dhe shfrytëzuar moshën më të vogël, pamjen e jashtme, statusin social, orjentimin seksual, përkatësitë racore dhe kombësinë ose dhe përkatësinë fetare. Kështu bullizmi shfaqet me karaktere të ndryshme dhe me forma të ndryshme si psh. kemi: bullizmi fizik, dmth abuzim me anë të dhunës së përsëritur të çdo forme të jashtme; bullizmin verbal me anë të fyerjes, nofkave, thashethemeve dashakeqe, shpifjeve; bullizmi social që do të thotë mënjanim nga grupi shoqëror në shkollë, ose në festa që organizon klasa, apo nxënës; bullizmi seksual, që është verbal me anë të fjalëve fyese, provokuese, por edhe fizik në ngacmime seksuale; bullizmi virtual me anë të rrjeteve sociale dmth keqpërdorimi i tyre për të dëmtuar ‘viktimën’ me postimin e fakteve apo thjesht shpifjeve publikisht; bullizmi racial nëpërmjet fyersjes dhe dhunës, apo edhe bullizmi fetar duke diskriminuar dhe fyer fenë ku nxënësi ose prindërit e tij besojnë.

Sipas përkufizimit të studiuesit australian Ken Rigby “Bullizmi është një dëshirë për të dëmtuar tjetrin, një dëshirë që dëmton, një veprim që lëndon një disbalacë në forcë midis personave një përsëritje në mënyrë

(tipike) një përdorim i padrejtë i forcës një kënaqësi e dukshme e agresorit si dhe një ndjenjë e përgjithshme e të qenit mbizotërus ndaj viktimës”.

Bullizmi zakonisht kryhet në një përqindje me të madhe nga djemtë që duan të bëjnë të fortin ose të parin në shkollë, por po shikohet një rritje e përqindjes dhe nga vajzat të cilat dëshirojnë kundër dhe natyrë femërore, të sillen si djemtë, të shajnë, të dhunojnë, të poshtërojnë viktimat e tyre.

Të gjithë fëmijët adoleshentë edhe të rinj që janë viktimat e bullizmit mbas një trysnie të përsëritur psikologjike dhe fizike shfaqin simptoma anormale të shoqëruara me ndjenja frike dhe ankthi për pasigurinë e tyre në ambjentet e shkollës. Kjo gjë ju krijon atyre trishtim mbyllje në vetvete, qëndrim në shtëpi të izoluar, mos vajtje në shkollë, rënje nga mësimet etj. Gjithë kjo gjëndje shpirtërore anormale shfaqet dhe me simptoma të tjera të jashtme si anoreksi, dhimbje koke, dhimbje stomaku, të vjella, përgjumje ose gjumë të trazuar etj. Nëqoftëse kjo gjëndje nuk menaxhohet mirë nga personi i viktimizuar, ndihmuar nga shkolla prindërit, shoqëria, atëhere gjëndja përkeqësohet kalon në dëshpërim, kthehet në depresion dhe lë pasoja

gjatë jetës dhe mund të marë trajta të ndryshme sëmundjesh psikologjike dhe fizike dhe mbi të gjitha këtyre siptomave, personi i bullizuar tenton vetëvrasjen. Sipas mjekëve psikiatër bullizmi e shton 6 derri në 9 herë idetë për suicid (vetëvrasje), ose nëqoftëse rrethjanat do të vinë në favorin e viktimës ai mund të kthehet në një hakmarës duke u bërë nga i viktimizuar në viktimizues.

Personat ose grupe që kryejnë bullizëm zakonisht janë pasqyrim i familjeve që kanë konflikte brënda tyre, ose janë tolerant ndaj dhunës duke i yshtur fëmijët e tyre të bëjnë të fortin nëpër shkolla. Disa të tjerë që kanë personalitet të cunguar për shkak të paaftësive intelektuale, dhunojnë për të bërë liderin dhe kontrollin me anë të force verbale apo fizike në shoqërinë ku janë. Të tjerë kanë problem dhe deformime psikologjike që duke viktimizuar të jerët ndjejë kënaqësi dhe përmbushje, ky tregues i një personaliteti antisocial me rezikshmëri shoqërore, që duhet trajtuar patjetër nga profesionistët e shëndetit mendor apo këshilluesin, punonjës social, psikologu.

Fatkeqësisht bullizmi në përqindjen më të madhe kryhet në ambjentet e shkollave në moshën feminare të nxënësve dhe adoleshënte por nuk përjashtohen raste edhe te të rinjtë. Ky

fenomen po ta mendosh drejt është një paradox kulturoro-social, sepse shkolla aspirohet të jetë si vëndi i shënjtë ku mësohet dija kultura, emancipohen brezat, duke u bërë më të mirë se pasardhësit tanë të çliruar nga konfliktet fisnore, gjinore, klasore, që i përkasin primitivizmit social.

Pavarësisht ndërgjegjësimit që po i bëhet këtij fenomeni nëpër shkolla me biseda, punës së diferencuar të psikologut punonjës social, ndërhyrjes prindërore, por edhe të vetë organizmave mbrojtës të fëmijëve siç është Linja Kombëtare e Këshillimit të Fëmijës Alo 16 CRCA në Shqipëri e mbështetur nga UNICEF, përsëri sipas statistikave në botë edhe në shqipëri bullizmi po përhapet si një epidemi me shumë viktima. Nga studimi i fundit në rang kombëtar nga studies europian dhe shqiptar në 141 shkolla nga klasa e 4 deri në të mesme, sipas pyetjeve nxënës mësues dhe prindër u kostatua se 1 në 5 nxënës ose mbi 20% janë prekur nga siptoma e bullizmit nëpër shkolla, 10% ja viktima, 6% agresor dhe 4% agresor edhe viktima bashkë. Si katekist (mësues feje) në K.O.A.SH dhe si prind me fëmijët e kësaj moshe ndihem i shqetësuar dhe mendoj se nuk duhet të rimë indiferent duke thënë vetëm “larg

shtëpisë time”, por secili sipas statusit dhe mundësisë duhet të japi kontributin që fenomeni të mos përparojë dhe të bëhet “epidemi sociale” ashtu siç po e ka trendin. Shumica e atyre që janë marë më problemin e bullizmit si shkak dhe parandalim pavarësisht punës dhe rezultateve që duhen përshëndetur, mendoj se kanë injoruar një fakt shkak dhe kryesor, që e ushqen bullizmin dhe që i shton viktimat e tij. *Është mungesa e besimit tek Perëndia!*



Po, sepse pavarësisht laicitetit të shoqërisë dhe sistemit arsimor, mohimi i faktorit Perëndi për formimin e nxënësve sipas idesë marksiste “feja opium për popullin”, koha po na tregon se nuk ka qënë gjë e mirë dhe nuk solli rezultatet të përsosjes morale siç pritej,

përkundrazi siç po shikojmë shturja dhe aroganca është shtuar nëpër shkollat ku injorohet formimi fetar. Jo vetëm në Shqipëri që trashëguam një sistem arsimor ateisto komunist të imponuar, por edhe në vëndet me një liri demokratike të shprehjes, injorimi i mësimi fetar mbi krijimin e botës dhe njeriut dhe mëshimi i teorisë ateiste mbi krijimin si ai darvinist “evolucionit të llojeve”, ku specia më e fortë zhvillohet duke sunduar dhe asimiluar më të dobting e ka dhënë produktin e vet, i cili siç thamë më

sipër është fenomeni i bullizmit. Ai fëmijë adoleshent apo i ri që është indoktrinuar nëpër shkolla me idenë ateiste se nuk ka një Perëndi Krijues, i cili është i kudondodhur, plot Dashuri për çdo qenie njerëzore, por edhe i Drejtë që e shpërblen të mirën dhe e dënon padrejtësinë, duke mos patur

frikë perëndie e ka shumë të lehtë që duke ju shmangur syve të mësuesve, prindërve, autoriteteve, ligjit, të abuzojë me të tjerët dhe aq më tepër mos ta vrasë ndërgjegjja, përkundrazi të ndjejë kënaqësi në përmbushje të vullnetit shqisor ,mishor, i pasionshëm i cili udhëhiqet nga instiktet e ulëta si ato të kafshëve të ligjit të xhunglës, ku më i forti sundon më të dobtin dhe ngrihet mbi viktimat e tij sipas “spirales evolucioniste”.

mosreagimin ndaj incidentit të bullizmit ose mund ta parandalojnë atë duke ndërhyrë (Salmivalli, 2001). Cairns dhe Cairns (1994) identifikuan ndikimin e grupeve të bashkëmoshatarëve. Ndërsa individët më shumë sesa grupet shfaqin sjellje bullizuese (Rigby dhe Slee, 1999), rreth 85% e incidenteve të bullizmit ndodhin brenda grupeve të bashkëmoshatarëve (Atlas dhe Pepler, 1997). Një studim mbi incidentet e bullizmit në këndet e lojërave, zbuloi se, megjithëse vëzhguesit ishin të pranishëm në 88% të incidenteve të bullizmit, ata ndërhyjnë vetëm në 19% të rasteve (Haëkins, Pepler dhe Craig, 2001).

Faktorët individualë

Predispozicioni i vetë bullizuesit. Fëmijët që kanë bullizuar janë raportuar se kanë empati të ulët dhe,



për këtë arsye, nuk janë të ndjeshëm ndaj gjendjes së vështirë të të tjerëve (Enderesen dhe Olëeus, 2001; Menesini et al., 1997). Vetë nxënësit dhanë arsyet e mëposhtme për bullizmin (Rigby, 2008): 1. Fëmija tjetër i mërzi ata. 2. Për të marrë hak. 3. Për argëtim. 4. E bënin edhe të tjerët këtë sjellje. 5. Sepse ata ishin mashtrues. 6. Për të treguar se sa të ashpër janë. 7. Për të marrë gjëra ose para. (vazhdon në nr. e ardhshëm)

BARCALETA**SHKENCA KA EVOLUAR**

Një burrë rreth të 50-ve pësoi një aksident shumë të rëndë nga i cili humbi për fatin e tij të keq "mikun". Kur shkoi për t'u vizituar te urologu, ky i fundit i dha shpresë:

- Tashmë shkenca ka evoluar dhe tani edhe ti ke mundësi ta rikuperosh "mikun" tënd.

Kemi tre lloje: të vogël 2000 Euro, të mesëm 4000 Euro dhe të madh 6000 Euro!

- Jam me dy mëndje midis të mesmit dhe të madhit, po do të të falenderoja nëse do më jepje pak kohë sa të pyes edhe gruan time! Merr në telefon gruan dhe pasi flet me të, kthehet në zyrën e doktorit i mërzhitur:

- Hë çfarë të tha gruaja?

- Më tha që, me aq pak sa e përdorim atë, me ato lekë më mirë bëjmë ca rregullime në shtëpi...

**MURI**

Nastradin si gjithmon ai te gjith njerzit i ka rrejt po njeni ka then se mu nuk mundesh me rrejt edhe e ka pa nastradinin pshtetun ne muri dhe i ka thon: o nastradin leshoma nje rren nese munesh.

Nastradini i ka thon: jo valla se nuk i kom me veti, i kom lon ne ship. Ai i ka thon ani a po shkon me i marr ne ship,

nastradini i thot shkoj vetem nese e man qet muri. Ai i thot mos ki dert ti ai e man murin e nastradini shkon e rrin ne shpi dhe i thot grus vet oj gru boma qata bukë se diqa urie. Ai han bukë e flen në gjum dhe kur qohet e she oren katë dhe thot kuku po une e kom lon njerin tu me prit. Shkon nastradini dhe ai njeri i thot: a i more rrenat, ai i thot po ku po don ma rren se qita se muri i ri nuk rrzohet e ti tu e majt?

NJË NATË GRUAJA

Një natë gruaja u zu me nastradinin, I dha të shtyre dhe e rrokullisi nëpër shkallë. Komshia e ndjeu zhurmën dhe të nesërmen e pyeti nastradinin.

- Çfarë ishte gjithë ajo zhurmë dje?
- Asgjë, vetëm se gruaja ime hodhi xhaketën nga shkallet.
- Çfarë një xhaketë vetëm bëri aq shumë zhurmë?
- Brenda saj isha dhe unë.

A FLUTURON DEVJA

E pyet një njeri Nastradinin:

- A fluturon devja?
- Nastradini thot PO, veç duhet me gjet një budalla që e beson.





SA KËMBË KA GOMARI?

- Nastradini hipur në gomar
 Takohet me një udhëtar
 Me hoxhën u mahit udhëtari
 E pyeti sa këmbë ka gomari.
 Nastradini zbriti ia numëroi
 Pastaj me zë atij i tregoi
- Unë e di-tha ai-po pse zbritte
 Sa këmbë ka gomari a nuk e dite?
 - Jo, jo unë e dita edhe pa zbritë



Po thash ta mbush ty kokën e mërðhitë.





ISSN 2671-387X